

## 1. Informacion i përgjithshëm

ALBGAZ sh.a është një shoqëri aksionere me kapital të regjistruar prej 359,068,000 lekë, i ndarë në 1,000 aksione me vlerë nominale 359,068 lekë/aksion, tërësisht i paguar.

Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet tek Njësia Administrative Nr. 5, Rr. Kosovareve, pallati Nderpo, Tiranë.

Shoqëria është themeluar më 6 janar 2017 me NIPT L71306034U.

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë është Z. Arber Avrami.

Objekti kryesor i veprimtarisë së Shoqërisë « ALBGAZ » sh.a është operimi si operator i kombinuar në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 102/2015, datë 23.09.2015 « Për sektorin e Gazit Natyror ». Për të realizuar këtë funksion, Shoqëria ushtron aktivitetin si Operator i sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 102/2015, datë 23.09.2015 « Për Sektorin e Gazit Natyror ».

Në 31 Dhjetor 2018 shoqëria ka 115 punonjës. (2017: 114 punonjës)

## 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

### 2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

### 2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### 2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### 2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### 2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

**2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)****2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)****2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve.

**2.5.2 Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste Shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

**3. Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

**3.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
EUR/Lek	123.42	132.95
USD/ Lek	107.82	111.10

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

##### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

##### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### 3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

#### 3.4. Aktive afatgjata materiale

##### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të ndërtaura vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### *ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

**3. Politikat Kontabël (vazhdim)****3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Normat e amortizimit për vitin 2018 dhe 2017 janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	3%
Ndërtesa	Vlera e mbetur	2%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	3%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	3%
Pajisje zyre	Vlera e mbetur	3%
Të tjera	Vlera e mbetur	2%

Toka nuk amortizohet.

*iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

**3.5. Grantet**

Grantet janë ndihmë e dhënë nga një organizëm qeveritar ose joqeveritar, në formën e transferimit të burimeve apo aktiveve të një njësie ekonomike, përkundrejt plotësimit në të shkuarën ose në të ardhmen të disa kushteve të paracaktuara që lidhen me aktivitetet e shfrytëzimit të kësaj njësie ekonomike.

Shoqëria i njeh grantet si vijon:

- Një grant që nuk imponon kushte të specifikuar të performancës në të ardhmen mbi përfituesin njihet në të ardhura, kur granti është arkëtuar.
- Një grant që imponon kushte të specifikuar të performancës në të ardhmen mbi përfituesin njihet në të ardhura vetëm kur kushtet e performancës janë plotësuar.
- Grantet e marra para se të plotësohet kriteri i njohjes së të ardhurave njihen si një detyrim.

Aktivitetet e marra ose të blera nëpërmjet granteve njihen në pasqyrën e pozicionit financiar në të njëjtën mënyrë siç njihen aktivitetet e tjera të të njëjtit lloj. Të ardhurat dhe shpenzimet, që lidhen me grantet, njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në zërat "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit dhe shpenzime të tjera të shfrytëzimit" ose si zë më vete.

**3.6. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje.

### 3. Politikat Kontabël (vazhdim)

#### 3.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

#### 3.8. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

#### 3.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

#### 3.10. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

#### 3.11. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

**3. Politikat Kontabël (vazhdim)****3.12. Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

**3.13. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

**4. Mjete monetare**

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Mjete monetare në bankë	95,025,272	143,390,872
Në Lekë	20,119,656	61,388,735
Në monedhë	74,905,616	82,002,137
Mjete monetare në arkë	-	-
	<u>95,025,272</u>	<u>143,390,872</u>

**5. Llogari të arkëtueshme tregtare**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Klientë Albpetrol	1,353,958	9,556,494
	<u>1,353,958</u>	<u>9,556,494</u>

**6. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
TVSH e arkëtueshme	946,085	-
Të arkëtueshme nga punonjës	661,329	661,329
	<u>1,607,414</u>	<u>661,329</u>

**7. Inventarë**

Inventari detajohet si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Inventar i imët	368,091	295,641
Karburant	47,461	454,442
Materiale të tjera	305,000	32,519
	<u>720,552</u>	<u>782,602</u>

**8. Pjesmarrje në shoqëri të kontrolluara**

Pjesmarrje në shoqëri të kontrolluara detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Pjesëmarrje në kompaninë ASG	2,625,000	-
	<u>2,625,000</u>	<u>-</u>



ALBGAS SH.A  
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2018  
(Vlerat janë në Lekë)

9. Aktive afatgjata material	Toka, troje dhe terrene	Ndërtesa	Makineri dhe Pajisje	Mjete transporti	Pajisje informatike	Mobilje e pajisje zyre	Totali
<b>Kosto</b>							
Gjendja më 1 janar 2017	-	-	-	-	-	-	-
Transferime nga Albptrol	139,570,475	20,664,688	889,991,825	-	-	193,932	1,050,420,920
Shtesa nga blerje						617,171	617,171
Grant nga Albpetrol						859,040	859,040
Grant nga TAP					8,915,927	5,769,927	14,685,854
Pakesime					(661,329)		(661,329)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>139,570,475</b>	<b>20,664,688</b>	<b>889,991,825</b>	<b>-</b>	<b>8,254,598</b>	<b>7,440,070</b>	<b>1,065,921,656</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>139,570,475</b>	<b>20,664,688</b>	<b>889,991,825</b>	<b>-</b>	<b>8,254,598</b>	<b>7,440,070</b>	<b>1,065,921,656</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>							
Gjendja më 1 janar 2017							
Transferime nga Albptrol		3,336,198	219,486,186			44,505	222,866,889
Amortizimi i vitit		221,877	1,942,848		66,702	65,139	2,296,566
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>-</b>	<b>3,558,075</b>	<b>221,429,034</b>	<b>-</b>	<b>66,702</b>	<b>109,644</b>	<b>225,163,455</b>
Amortizimi i vitit		221,876	1,931,902		242,287	183,891	2,579,956
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>-</b>	<b>3,779,951</b>	<b>223,360,936</b>	<b>-</b>	<b>308,989</b>	<b>293,535</b>	<b>227,743,411</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>							
Gjendja më 31 dhjetor 2017	139,570,475	17,106,613	668,562,791	-	8,187,896	7,330,426	840,758,201
Gjendja më 31 dhjetor 2018	139,570,475	16,884,737	666,630,889	-	7,945,609	7,146,535	838,178,245

## 10. Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	AAJM	Total
<b>Me kosto</b>		
Gjendja më 1 janar 2017		-
Shtesa nga blerje	2,000,000	2,000,000
Grant nga Albetrol	1,056,858	1,056,858
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>3,056,858</b>	<b>3,056,858</b>
Shtesa	1,000,000	1,000,000
Pakësime		-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>4,056,858</b>	<b>4,056,858</b>
<b>Amortizimi</b>		
Gjendja më 1 janar 2017		-
Amortizimi i vitit	69,510	69,510
Kthim amortizimi		-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>69,510</b>	<b>69,510</b>
Amortizimi i vitit	278,040	278,040
Kthim amortizimi		-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>347,550</b>	<b>347,550</b>
<b>Gjendja neto më 31 dhjetor 2017</b>	<b>2,987,348</b>	<b>2,987,348</b>
<b>Gjendja neto më 31 dhjetor 2018</b>	<b>3,709,308</b>	<b>3,709,308</b>

## 11. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Hua Albetrol	163,191,430	127,462,430
Hua OST	20,000,000	-
	<b>183,191,430</b>	<b>127,462,430</b>

## 12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Furnitorë	19,178,285	9,313,907
Furnitorë për fatura të pambërritura	901,671	-
	<b>20,079,956</b>	<b>9,313,907</b>

**13. Të pagueshme ndaj njësive ekonomike**

Të pagueshmet ndaj njësive ekonomike më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Kapital i pa derdhur ndaj AGS	1,750,000	-
	<u>1,750,000</u>	<u>-</u>

**14. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Tatimi në burim	29,741	26,537
TAP	681,170	588,582
Sigurime shoqërore	1,762,259	1,642,000
TVSH e pagueshme	-	164,350
	<u>2,473,170</u>	<u>2,421,469</u>

**15. Të tjera detyrime**

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Paga të pagueshme	6,982,641	6,475,388
	<u>6,982,641</u>	<u>6,475,388</u>

**16. Hua afatgjata**

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Hua Albpetrol	30,000,000	-
Hua OST	-	20,000,000
	<u>30,000,000</u>	<u>20,000,000</u>

**17. Grante dhe të ardhura të shtyra**

Grantet dhe të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Asete të dhuruara	16,041,215	16,691,002
Dhurim likuiditetesh për rikonstruksion zyrash në Fier	82,435,320	82,435,320
	<u>98,476,535</u>	<u>99,126,322</u>

**18. Kapitali**

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është në vlerën 359,068,000 Lekë (2017: 359,068,000 Lekë).

Shuma prej 468,729,158 Lekë përfaqëson primin e lidhur me kapitalin (2017: 468,729,158Lekë).

Humbja e mbartur më 31 dhjetor 2018 është në vlerën (94,459,826) Lekë.

Rezultati i ushtrimit paraqitet në vlerën (133,071,313) Lekë (2017: (94,459,828) Lekë).

**19. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit**

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Të ardhura nga transmetimi i gazit	11,261,859	19,208,475
	<u>11,261,859</u>	<u>19,208,475</u>

**20. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Të ardhura nga rimarrja e grantit	649,788	342,233
Rezultati neto nga këmbimet valutore	(5,860,566)	(431,763)
	<u>(5,210,778)</u>	<u>(89,530)</u>

**21. Lëndë e parë dhe material të konsumueshme**

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materialet e konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	415,390	67,779
Konsumi i inventarit të imët	72,450	52,512
Lëndë djegëse	636,982	1,732,817
	<b>1,124,822</b>	<b>1,853,108</b>

**22. Të tjera shpenzime**

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Blerje	185,027	-
Shpenzime për energji, ujë	10,183,314	7,410,894
Shpenzime liçencimi	2,821,501	123,546
Shpenzime mirëmbajtjeje	-	998,000
Udhëtime e dieta	2,799,566	3,793,098
Shpenzime transporti	300,000	-
Qira	5,079,672	771,550
Shpenzime ligjore	2,706,060	206,159
Shpenzime telefon dhe internet	646,729	368,130
Komisione dhe tarifa bankare	166,833	87,557
Tatime dhe taksa vendore	-	197,000
Shpenzime pritje e përcjellje	319,214	377,134
Të tjera shpenzime	2,106,705	2,230,858
	<b>27,314,621</b>	<b>16,563,926</b>

**23. Shpenzime të personelit**

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime paga	95,890,762	82,340,152
Shpenzime për sigurime shoqërore	11,982,531	10,481,260
	<b>107,873,293</b>	<b>92,821,412</b>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2018 është 115 (31 dhjetor 2017: 114).

**24. Shpenzime konsumi dhe amortizimi**

Shpenzimet e konsumit dhe amortizimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime amortizimi	2,857,996	2,366,076
	<b>2,857,996</b>	<b>2,366,076</b>

**25. Shpenzime financiare**

Shpenzimet financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat dhe të ardhura të tjera financiare që lidhen me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë paraqitet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime për interesa	(606)	(70)
Të ardhura nga interesat	48,944	25,819
	<b>48,338</b>	<b>25,749</b>

**26. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
<i>Fitimi para tatimit</i>	(133,071,313)	(94,459,828)
Total shpenzime të panjohura	-	-
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	(133,071,313)	(94,459,828)
Humbje fiskale e mbartur	(94,459,828)	
<i>Tatim fitimi @15%</i>	-	-
	<b>(133,071,313)</b>	<b>(94,459,828)</b>

**27. Angazhime dhe pasiguri***Detyrimet tatimore*

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

**28. Ngjarje pas bilancit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.